



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR PENALITETET E ZBATUARA NË RASTIN E TËRHEQJES SË PARAKOHSHME
NGA FONDI I PENSIONIT VULLNETAR**

Miratuar me Vendim Bordi nr. 125, datë 7.12.2010

**Neni 1
Objekti**

Objekti i rregullores është përcaktimi i kufirit dhe mënyrës së zbatimit të penalitetit në rast të tërheqjes së parakohshme nga anëtari të aseteve nga llogaria individuale në fondin e pensionit vullnetar, (këtu e më poshtë ‘Tërheqja e parakohshme’).

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret ne bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 10 197, datë 10.12.2009, ‘Për fondet e pensionit vullnetar’, këtu e më poshtë ‘Ligji’. Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim dhënë atyre në Ligj.

**Neni 3
Llogaritja e penalitetit**

1. Penaliteti në rastin e tërheqjes së parakohshme llogaritet mbi vlerën neto të aseteve të kërkuara për t’u tërhequr para kohe, pasi është zbritur tatimi sipas legjislacionit në fuqi në momentin e tërheqjes. Asetet mbi të cilat zbatohet penaliteti i tërheqjes së parakohshme, këtu e më poshtë në rregullore do të quhen ‘asete të tërhequra’.
2. Penaliteti në rastin e tërheqjes së parakohshme llogaritet nga Shoqëria Administruese në raport me kohën e përmbushur nga anëtari, nga çasti i kontributit të tij të parë e deri në çastin e tërheqjes së parakohshme.

3. Shoqëria Administruese përcakton penalitetin në rastin e tërheqjes së parakohshme brenda kufijve të mëposhtëm:
 - i. Jo më pak se 2% dhe jo më shumë se 5% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë;
 - ii. Jo më pak se 5% dhe jo më shumë se 10% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
 - iii. Jo më pak se 10% dhe jo më shumë se 15% të aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
 - iv. Jo më pak se 15% dhe jo më shumë se 20% të aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të.
4. Për efekt të llogaritjes së penalitetit të tërheqjes së parakohshme, si datë e kontributit të parë do të konsiderohet data e parë e derdhjes së kontributit në fondin e parë të pensionit.

Neni 4

Procedura e zbatimit të penalitetit

1. Penaliteti i tërheqjes së parakohshme administrohet nga Shoqëria Administruese, përpara kryerjes së veprimit të tërheqjes së parakohshme nga ana e anëtarit të Fondit të Pensionit Vullnetar.
2. Shoqëria Administruese brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës së Anëtarit, urdhëron Depozitarin, i cili përpara se të kryejë pagesën e aseteve që do të tërhiqen nga Anëtari, mban penalitetin e tërheqjes së parakohshme dhe e kalon për llogari të Shoqërisë Administruese të fondit të pensionit vullnetar.
3. Në rastin kur Anëtari transferon asetet në një fond tjetër të pensionit vullnetar, për efekt të llogaritjes së penaliteteve në rastin e tërheqjes së parakohshme të aseteve nga Fondi i ri, në kohëzgjatjen e anëtarësimit do të përfshihet edhe periudha e anëtarësimit në fondin e mëparshëm.

Neni 5
Detyrimi për informim

1. Parashikimi për penalitetin i zbatueshëm në rastin e tërheqjes së parakohshme dhe masa e penalitetit, duhet të evidentohet qartë dhe të shkruhet në vend të dukshëm në kontratën e fondit vullnetar të pensionit dhe në prospektin e fondit.
2. Me marrjen e kërkesës për tërheqje të parakohshme nga ana e anëtarit të fondit të pensionit, shoqëria administruese duhet t'i shpjegojë qartë atij pasojat financiare që i shkaktohen nga përfundimi dhe marrja e pagesës nga fondi i pensioneve, përpara arritjes së moshës së pensionit, ose plotësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 16 të Ligjit.

Neni 6
Dispozita kalimtare

1. Penalitetet e tërheqjes së parakohshme nuk do të aplikohen ndaj Anëtarëve të Instituteve Private të Pensioneve, të cilët kalojnë automatikisht në një fond të pensionit vullnetar për shkak të pamundësisë së kontaktimit nga Shoqëria Administruese, kur ata vendosin të ndërpresin anëtarësimin dhe të tërheqin asetet e tyre nga llogaria personale.
2. E drejta për t'u tërhequr nga Fondi pa penalitet për Anëtarët e Instituteve Private të Pensioneve, të cilët kalojnë automatikisht në një fond të pensionit vullnetar, do të parashkruhet brenda 3 vjetësh nga momenti i transferimit në Fond.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI